REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr.2124 Prot.

Vlorë, më 22. 10 2026

PROJEKTVENDIM

Nr._____, Datë _____2026

" PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR USHTRIMIN E FUNKSIONIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË PËR VITIN 2027 "

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, pjesa e gjashtë "Qeverisja Vendore" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenit 9, Nenit 53 , Nenit 54 pika "dh" dhe "k" të Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar me Ligjin Nr.38/2019, Ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë" miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.11, datë 30.01.2020, me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Këshilli i Bashkisë Vlorë ,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për shpenzime për ushtrimin e funksionit të Këshillit të Bashkisë Vlorë për vitin buxhetor 2027, sipas relacionit dhe tabelave të detajuara të shpenzimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi i përgjithshëm i miratuar për funksionimin e Këshillit Bashkiak prej 10,117,000 lekë, do të jetë pjesë integrale e Buxhetit vjetor të Bashkisë Vlorë për vitin 2027.

3. Fondi në total i miratur do të përdoret për të mbuluar shpenzimet e mëposhtme:
   - Shpenzime operative dhe mirëmbajtje: Për funksionimin e sallës së mbledhjeve, mjete kancelarie, shtypje materialesh dhe shërbime të ngjashme administrative.
   - Shpenzime për shërbime dhe botime: Për sigurimin e transparencës së vendimmarrjes (afishime publike, njoftime, mirëmbajtje të sistemeve digjitale të votimit/transmetimit).

- Shpenzime operative - administrative për organizimin e mbledhjeve, materiale kancelarie, komunikim, botime të vendimeve dhe shpenzimeve tjera logjistike).
- Shpenzime për trajnime, konsulenca dhe shërbime në funksion të rritjes së kapaciteteve të këshilltarëve.
- Shpenzime për pritje, delegacione , aktivitete zyrtare , organizimin e dëgjesave publike dhe seancave të hapura me qytetarët.

4. Ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit për pasqyrimin e këtyre shpenzimeve në Buxhetin Vjetor të Bashkisë Vlorë si dhe Sekretaria e Këshillit Bashkiak për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Projektvendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të Nenit 55 dhe 60 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

KËRKESA PËR SHPENZIME PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË PËR VITIN 2027.

Tabela Nr.1 Tabela analitike e shpenzimeve.

Nr.	Emertimi i Shpenzimeve	Vlera Vjetore
1.	Përmbledhje e vendimeve të Këshillit per vitin 2026	130,000
2.	Botime periodike të Keshillit, gazeta juridike, fletëpalosje	150,000
3.	Blerje karta urimi per festa	25,000
4.	Dërgimi me postë i dokumenteve, shkresave të Këshillit dhe Këshilltarëve.	12,000
5.	Kancelari për zyrë	300,000
6.	Shpenzime udhëtimi	800,000
7.	Shpenzime për Aleancën e Grave Këshilltare	900,000
8.	Vizita studimore të Këshilltareve	3,800,000
9.	Trajnime për Këshilltarët	500,00
10.	Shpenzim për pritje, delegacione, aktivitete zyrtare	800,000
11.	Shpenzimet për mbledhjet e Këshillit	300,000
12.	Flamur për Mbledhjen e Këshillit dhe Flamur Kombëtar, Logo e Bashkisë	300,000
12.	Shpenzime për shërbime financiare	1,500,000
13.	Shpenzime operative të paparishikuara	600,000
	Shuma Totale	10,117,000

KRYETARE

Elpiniqi Mërkuri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2124/Prot. Vlorë, më 22. 10 2026

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR SHPENZIME PËR USHTRIMI E FUNKSONIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORË PËR VITIN 2027

Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Ky relacion shoqëron projekt-vendimin për miratimin e fondit buxhetor të dedikuar për ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit Bashkiak Vlorë. Qëllimi kryesor është miratimi i fondit të nevojshëm buxhetor që garanton ushtrimin e plotë të funksioneve të këshilltarëve bashkiakë, komisioneve të përhershme dhe Sekretarisë së Këshillit.
Projekt-vendimi mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi për Vetëqeverisjen Vendore në Republikën e Shqipërisë:

- Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar: Neni 9 (Pika 1.3), Neni 53 dhe Neni 54, të cilët rregullojnë kompetencat e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit dhe menaxhimin e strukturave të tij ndihmëse.
- Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore": I cili përcakton rregullat për alokimin dhe përdorimin e fondeve publike në nivel lokal, si dhe
- Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Vlorë, miratuar me Vendim Nr.11, datë 30.01.2020 të Këshillit të Bashkisë.

Këtë projektvendim e paraqesim për miratim në Këshillin e Bashkisë referuar nenit 113 të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Bashkisë", i cili parashikon që Këshilli i Bashkisë miraton shpenzimet e domosdoshme për mundësuar ushtrimin normalisht të funksioneve të tij dhe ja paraqet Administratës së Bashkisë për ta bërë pjesë të Buxhetit Vjetor të Bashkisë.

Projektvendimi po ju paraqesim lidhet me kërkesat për shpenzime të Këshillit të Bashkisë përsa i përket shpenzimeve të domosdoshme për vitin 2027. Bashkëlidhur këtij projektvendimi janë pasqyruar shpenzimet për honoraret për Këshilltarët, për Kryetarët e Fshatrave, paga dhe sigurimeve shoqërore për punonjësit e Sekretariatit të Këshillit, si dhe shpenzimet operative dhe disa investime të domosdoshme për funksionimin normal të Këshillit të Bashkisë.

Fondi i kërkuar do të ndahet sipas zërave kryesorë të mëposhtëm:

- Shpenzime Operative dhe Kancelari: Mbulimi i kostove për materiale zyre, tonera, shtypje të volumeve të mëdha të projekt-vendimeve dhe dërgimin e materialeve zyrtare për anëtarët e këshillit përpara çdo mbledhjeje.
- Transparenca dhe Digjitalizimi: Financimi i sistemeve të transmetimit live të mbledhjeve (audio/video) në platformat sociale dhe faqen zyrtare, për të garantuar të drejtën e qytetarëve për informim.
- Organizimi i Dëgjesave Publike: Financimi i logjistikës për takimet e detyrueshme ligjore me komunitetin, dëgjesat për buxhetin pjesëmarrës dhe takimet e komisioneve në terren nëpër njësitë administrative të Bashkisë Vlorë.
- Shpenzime për pritje, delegacione , aktivitete zyrtare

Fondet e kërkuara për ushtrimin e funksioneve të Këshillit Bashkiak janë të parashikuara brenda tavanit buxhetor të miratuar për vitin përkatës në zërin e shpenzimeve operative të aparatit të Bashkisë. Ky projekt-vendim nuk kërkon shtesë fondesh apo rishikim të buxhetit të përgjithshëm, por thjesht autorizon detajimin dhe përdorimin e këtij zëri sipas nevojave reale të Këshillit.
Sikurse theksuam më lart, në tabelën e Buxhetit të Këshillit të Bashkisë Vlorë që shoqëron projektvendimin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar kërkesat për shpenzimet e vlerësuara domosdoshme.
V.O Për shpërblimet mujore të anëtarëve të Këshillit Bashkiak (në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë sipas legjislacionit në fuqi) si dhe Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e Sekretariatit të Këshillit të Bashkisë janë të implementuara në projekt buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2027.
Në rast se ka kërkesa të ndryshme nga këshilltarët mund të propozojnë ndryshime, pakësime ose shtesa të cilat mund të bëhen pjesë e këtij projektivendimi me kërkesat paraqitur për miratim. Nga sa më lartë, propozojmë të miratoni këto kërkesa me qëllim që ti përcillen Administratës së Bashkisë e cila aktualisht është duke realizuar proçedurat përkatëse për hartimin dhe miratimin e Buxhetit të Bashkisë për vitin 2027.
Nisur nga sa më sipër, ftojmë anëtarët e Këshillit të Bashkisë Vlorë shqyrtimin dhe miratimin e këtij Projektvendimit.

KRYETARE

Elpiniqi Mërkuri